



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 16, datë 27.04.2018

PËR

RISHIKIMIN E KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT EKZISTUES PËR RESORTIN
TURISTIK "SAN PIETRO", ME VENDNDODHJE NË GJIRIN E LALZIT, BASHKIA
DURRËS

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të shoqërisë "Concord-Investment" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të lejes së ndërtimit ekzistues për resortin turistik "San Pietro", me vendndodhje në Gjirin e Lalzit, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë "Concord-Investment" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 05.05.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për projektin Ndërtimi i Kompleksit Turistik "San Pietro", Komuna Ishëm, Qarku Durrës", zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Dokumenti i ri i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDJ RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

